



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.192/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ, të paditësit “B...” Sh.P.K. me seli në Viti, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlerë kontesti 1,000.00 EUR në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur me datë 11.10.2022, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Avokat K.B dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur B.G, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “B...” Sh.P.K. me seli në Viti, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B Avokat në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr. 01.3.2.2/17969 i datës 05.11.2021 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A R S Y E T I M

Paditësi “B...” Sh.P.K. me seli në Viti, me padinë e paraqitur në Gjykatë përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat K.B, me datë 09.12.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës të aprovet kërkesëpadia si e bazuar, të anulohet aktvendimi 01.3.2.2/17969 i datës 05.11.2021 dhe të detyrohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit t’ia kthej mjetet e paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit të paguara më tepër mbi vlerën e transaksionit me kamatë ligjore 8%. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se : e paditura ka bërë shkeljet ligjore dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në mënyrën siç është elaboruar në padi. Paditësi ankesës tek e paditura i ka bashkangjitur faturat e mallit dhe deklaratat eksportuese, si dhe e ka njoftuar të paditurën që Transaksionet Bankare në emër të Faturave nuk janë realizuar ende. Megjithatë e paditura nuk ka pezulluar procedurën në pritje të këtyre pagesave, por e ka refuzuar ankesën si të pa bazuar. Paditësi Transaksionet Bankare në emër të

Faturave i ka realizuar pas parashtrimit të ankesës tek e paditura, dhe të njëjtit i dorëzon gjykatës në këtë seancë në kopje të mjaftueshme edhe për palën e paditur, përkatësisht Transaksionet e datës 10.10.2021, 13.10.2021, 15.10.2021, 25.10.2021, 28.10.2021, 06.11.2021, 11.11.2021, 11.11.2021 dhe 13.11.2021. Prandaj, në bazë të këtyre Transaksioneve vërtetohet çmimi i paguar nga paditësi në emër të mallit, dhe konsiderojmë se në bazë të tyre është e nevojshme rishqyrtimi edhe një herë i kësaj lënde nga e paditura. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 05.04.2022 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr komfor të të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaron se : Aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi, dhe ajo në të cilën pretendon paditësi se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. E kontestojmë vlerën e kontestit të palës paditëse, e cila duhet të jetë 896.39 € e cila duhet të jetë e saktë, e jo siç e ka paraqitur pala paditëse në padi. Gjithashtu, theksojmë se as në fazën e zhdoganimit dhe as në fazën e ankesës pala paditëse nuk ka prezantuar dokumentet siç janë Transferet Bankare dhe Kontratën e Shitblerjes, por vetëm ka dërguar ankesën kundër Deklaratave Doganore të datës 18.09.2021. Gjithashtu, në padinë e palës paditëse në faqen 3 aty ku thekson se importuesi ka afat për pritje për pagesë është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme, sepse askund në fatura nuk shihet afati për pritje për pagesë, dhe mbi bazën e kësaj Dogana ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlera më e vogël se sa vlera e paguar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi Nr.01.3.2.2/17969/05.11.2021, Përgjigja në Padi e datës 05.04.2022,

Proceset mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave për DUD-at kontestues 23712, 24068, 23775, 24875, 24874, Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës Nr.17969 e datës 20.09.2021, DUD-at 23618/19.08.2021, 23712/20.08.2021, 23713/20.08.2021, 23728/20.08.2021, 23775/20.08.2021, 24068/24.08.2021, 24365/26.08.2021, 24874/31.08.2021, 24875/31.08.2021, Faturat numër 2000058317, 0000008627, 1100121832, 0000008642, 0000008645, 0000008667, 0000008674, 0000008712, 0000008713, Deklaratat EXA, Transaksionet Bankare Ndërkombëtare të realizuara në bankën BPB të datës 10.10.2021, 13.10.2021, 15.10.2021, 25.10.2021, 28.10.2021, 06.11.2021, 11.11.2021, 11.11.2021 dhe 13.11.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-i kontestues i Doganës së Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur DUD-at R-23618/18.08.2021, R-23712/20.08.2021, R-23713/20.08.2021, R-23728/20.08.2021, R-23775/20.08.2021, R-24068/24.08.2021, R-24365/26.08.2021, R-24874/31.08.2021, R-24875/21.08.2021 për zhdoganim pranë Zyrës Doganore Ferizaj, me ç'rast i njëjti është proceduar, duke u ri-vlerësuar bazuar në metodën e 6-të. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 05.11.2021, ka sjell Aktvendimin nr. 01.3.2.2/17969 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar kërkesat e subjekti në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 09.12.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për rishqyrtimin e deklaratave unike doganore DUD-it R-23618/18.08.2021, R-23712/20.08.2021, R-23713/20.08.2021, R-23728/20.08.2021, R-

23775/20.08.2021, R-24068/24.08.2021, R-24365/26.08.2021, R-24874/31.08.2021, R-24875/21.08.2021. E paditura ka vlerësuar se Sektori i pranimit qendror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Tutje theksohet se dokumentacioni përcjellës i mallrave lëndor kontestues është konsideruar i pamjaftueshëm, pasi që Dogana disponon me të dhëna nga dosja e vlerës dhe se subjekti këtu paditësi nuk ka deklaruar vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor. Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse nuk është pranuar vlera e transaksionit, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar, dhe nuk është dhënë asnjë provë për tu dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës së mallit, për të dëshmuar konstatimin e dhënë se vlerës së mallit të deklaruar për zhdoganim nuk duhet t'i pranohet vlera e transaksionit.

Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, Gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Sektori e Pranimit Qendror ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33, të KDA-së, mirëpo një konstatim i tillë për Gjykatën është tërësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova materiale, është shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, dhe sepse e paditura nuk ka qenë të gjendje të provojë këtë konstatim, kjo edhe përmes ndonjë dëshmie me të cilin do të argumentohet se paditësi, nuk i ka paguar eksportuesit përmes transaksionit

bankar çmimin e faturës apo se i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës blerëse të mallit.

Gjykata ka shqyrtuar vendimin kontestuese dhe pretendimet e paditësit lidhur me mospranimin e vlerës së mallit, duke konstatuar se paditësi, ka provuar që me prova bindëse të dëshmoj para Doganës që në kuptim të dokumenteve përcjellëse të prezantuara, paditësi në këtë rast ka prezantuar urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të realizuara në bankën BPB të datës 10.10.2021, 13.10.2021, 15.10.2021, 25.10.2021, 28.10.2021, 06.11.2021, 11.11.2021, 11.11.2021 dhe 13.11.2021 dhe e cila janë të harmonizuar në tërësi në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit me faturat numër 2000058317, 0000008627, 1100121832, 0000008642, 0000008645, 0000008667, 0000008674, 0000008712, 0000008713. Gjykata vlerëson se legjislacioni doganor nuk përmban dispozita ku thuhet se vlera doganore e mallrave të importuara, duhet të jetë në përputhje me vlerën e të dhënave të disponueshme nga Dogana e Kosovës, në rastet kur ka dokumentacion përcjellës të harmonizuar, por përkundrazi tek neni 33 par.1 të KDA-së është parashikuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*.

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet të konstatoj këto pretendime të cekura si më lartë dhe argumentet e paditësit dhe të deklarojë lidhur me provat e administruara përkatësisht urdhërpagesën bankare ndërkombëtare të realizuara në bankën BPB të datës 10.10.2021, 13.10.2021, 15.10.2021, 25.10.2021, 28.10.2021, 06.11.2021, 11.11.2021, 11.11.2021 dhe 13.11.2021 dhe e cila janë të harmonizuar në tërësi në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit me faturat numër 2000058317, 0000008627, 1100121832, 0000008642, 0000008645, 0000008667, 0000008674, 0000008712, 0000008713. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se e paditura nuk ka shqyrtuar drejtë pretendimet e paditësit për të konstatuar se fatura dhe dokumentet tjera përcjellëse, përse janë kontestuar, pra nuk janë marr për bazë dhe nuk i kanë pranuar si valide, andaj një akt administrativ i tillë nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata.

Tutje e paditura nuk është deklaruar fare lidhur me deklaratat eksportuese të mallit kur dihet se e njëjta ka qenë të bashkangjitur DUD-ve kontestues në procedurë të zhdoganimit të mallit, dhe se e njëjta përmbajnë të dhëna lidhur me mallin,

eksportuesin, importuesin, origjinën, peshën neto dhe bruto, dhe të dhëna të tjera. E paditura nuk është deklaruar fare as lidhur me provat në të cilat është bazuar respektivisht në të dhënat e disponueshme, apo dosja e vlerës siq është referuar, janë mallra që kanë të bëjnë me përshkrim-malli identik apo të ngjashëm me mallin lëndor kontestues, se janë nga i njëjti shtet eksportues, me kod tarifor identik, origjinë të njëjtë, sasi të njëjtë apo të përafërt, në mënyrë që të mund të zbatohen në rivlerësimin e mallit të zhdoganuar me DUD-at R-23618/18.08.2021, R-23712/20.08.2021, R-23713/20.08.2021, R-23728/20.08.2021, R-23775/20.08.2021, R-24068/24.08.2021, R-24365/26.08.2021, R-24874/31.08.2021, R-24875/21.08.2021.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u deshtë që doemos të anulohet, tutje Gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohet lidhur me provat e paraqitura nga paditësi lidhur me deklaratat unike doganore R-23618/18.08.2021, R-23712/20.08.2021, R-23713/20.08.2021, R-23728/20.08.2021, R-23775/20.08.2021, R-24068/24.08.2021, R-24365/26.08.2021, R-24874/31.08.2021, R-24875/21.08.2021, dhe të administruar nga Gjykata e të cilat u përmenden më lartë.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri, e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit të deklarohet lidhur me të dhënat e aplikuar me rastin e rivlerësimit të mallit kontestues dhe të aplikoj drejt dispozitat ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi. E paditura në rivendosje të ketë parasysh edhe kumatën e cila gjen mbështetje në dispozitat e KDAK-së, Kodi Nr. 03/L-109, neni 292, pika b), “Në rast se çështja zgjidhet

përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: ((b) Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”, në rastin konkret e njëjta është e aplikueshme ngase këtu paditësi e ka parashtruar si kërkesë.

Vendimi që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.192/22 datë 11.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar GASHI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.